



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 42, datë 02.04.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “OBJEKT BANIMI,
SHËRBIMI DHE HOTELERI “VLORA OLD BEACH BUILDING”, ME 14 KATE MBI
TOKË DHE 3 KATE PARKIMI NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË
VLORË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Fa Albanian Investment” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Objekt banimi, shërbimi dhe hoteleri “Vlora Old Beach Building”, me 14 kate mbi tokë dhe 3 kate parkimi nëntokë” me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Fa Albania Investment” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 29/04/ 2025